



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:159661
Datë: 11.07.2024
Numri i dokumentit: 05928281

AA.nr.353/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit L.P, nga Klina, kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë- Komisioni për Dhënien e Provimit për Përmbarues Privat në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1906/2022, të datës 05.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit L.P, nga Klina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1906/2022 i datës 05.05.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1906/2022, të datës 05.05.2023, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpapia e paditësit L.P, nga Klina, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurit Ministria e Drejtësisë - Komisioni për Dhënien e Provimit për Përmbarues Privat në Prishtinë i datës 08.07.2022.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të priset në tersi aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1906/2022 i datës 05.05.2023, të aprovet në tersi padia dhe kërkesëpadia e paditësit L.P nga Klina, si e bazuar, të anulohet konkursi për shpalljen publike për dhënien e provimit për përmbaues privat i datës 27.04.2022 deri me datën 15.05.2022, dhe bëhet rishpallja e konkursit, të lejohet përsëritja e provimit me shkrim për përmbauesit privat, në bazë të nenit 26 par.2, nënpar.2,1 të LKA-së, ose mënyra e zgjidhjes së detyrës së punuar me shkrim nga unë kandidati L.P, te konsiderohet si detyrë e zgjidhur në mënyrë të drejtë, të saktë, dhe të më njihet kalimi i provimit me shkrim për Përmbaues Privat.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Ministria e Drejtësisë – Komisioni për dhënien e provimit të përmbauesit privat, me vendimin nr.231/2022, të datës 08.07.2022, nën pikën I të dispozitivit të vendimit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e z.L.P, nga Klina e ushtruar kundër rezultatit të Provimit të Përmbauesit privat, të mbajtur me datë 02.07.2022, i publikuar me datë 03.07.2022. Nën pikën II të dispozitivit ky vendim ka hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është përfundimtar.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të Ministrisë së Drejtësisë – Komisioni për dhënien e provimit të përmbauesit privat, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, e duke u bazuar në provat dhe dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Me arsyetim se nga provimi për përmbaues privat,

këtu paditësi ka arritur suksesin e përgjithshëm prej 16 pikëve, referuar detyrës së punuar bashkangjitur në shkresat e lëndës, si dhe procesverbalit të komisionit të datës 02.07.2022, në këtë kuptim bazuar në shkresat e lëndës këtu paditësi nuk ka arritur me prova konkrete të dëshmoj se i njëjti ka plotësuar kushtet nga neni 13 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2013 e ku përcaktohet se provimi me shkrim konsiderohet i kaluar nëse kandidatët arrijnë një minimum prej 25 pikëve, mbi këtë bazë edhe konstatohet se pretendimet e këtu paditësit janë të pabazuar në vështrim të dispozitave ligjore nga neni 9, 10,13 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2013. Sa i përket pretendimit sipas të cilët deklarohet se u është paraqitur detyrë e cila ka qenë kompetencë ekskluzive e gjyqtarit përmbarues, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se parashtrimi i detyrës së tillë dhe e cila kundërshtohet me padi nga paditësi, në fazën kur paditësi i është nënshtruar provimit dhe me pranimin e detyrës nuk është dhënë asnjë vërejtje lidhur me detyrën, Gjykatës nuk i është paraqitur asnjë vërejtje apo kundërshtim lidhur me detyrën e parashtruar, nga shkresat e lëndës dhe deklaramet në shqyrtim gjyqësor konstatohen se nga kandidatë nuk ka pasur vërejtje lidhur me detyrën por se të njëjtit përfshirë këtu paditësin i janë nënshtruar provimit dhe këtu paditësi vetëm pas pranimit të rezultatit në të cilat konstatohet se nuk ka arritur pikët e parapara, me inicimin e procedurë administrative dhe gjyqësor konteston mes tjerash detyrën e cila konsideron se është kompetencë ekskluzive e gjyqtarit përmbarues, andaj një pretendim të tillë Gjykata e shkallës së parë nuk e mori për bazë sepse paditësi një pretendim të tillë e ka referuar vetëm pas rezultatit të marrë dhe atë kur paditësi sipas shkresave të lëndës nuk ka arritur pikët e përcaktuar me dispozita ligjore për arritjen e kalimit të provimit, ku Gjykata e shkallës së parë konstaton se vlerësimi i detyrës është bërë konform dispozitave të nenit 13 të UA 02/2013 dhe se paditësi nuk ka arritur pikët e mjaftueshme në mënyrë që provimi të konsiderohet i kaluar.

Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, andaj bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ të atakuar me padi, por se në këtë shqyrtim gjyqësor paditësi nuk ka arritur me prova konkrete të dëshmoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar në këtë shqyrtim gjyqësor andaj edhe kthimi i lëndës në rishqyrtim të e paditura bazuar në formën e aktit administrativ paraqet zvarritje

të procedurës sepse nuk është dëshmuar gjendje tjetër faktike nga kjo e konstatuar në shqyrtim gjyqësor.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurit në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike se *“gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar apo jo të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike për detyrën e parashtruar nga ana e komisionit, se çfarë natyre ka përmbajtja e detyrës, cila është mënyra e saktë e zgjedhjes së detyrës, e vërteton vetë përmbajtja e detyrës, se në rastin konkret kemi të bëjmë me një detyrë (propozim për përmbarim), që është nga marrëdhënia e punës..”*. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase konsideron se të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara. Sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë, si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ngase paditësi me asnjë provë nuk ka argumentuar vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë, në gjykatën e shkallës së parë e as me ankesën e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate vendimi i kontestuar i të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, dhe si i tillë aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lartcekur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.353/2023, me datë 08.07.2024

Kryetari i kolegjit

Ramiz Kuqi